

KUD 368.4 (496.51)

MUNGESA E LEGJISLACIONIT NË SFERËN E LIBERALIZIMIT TË INDUSTRIË SË SIGURIMEVE NË KOSOVË

*Dr.sc. Armand Krasniqi, prof.ass.1
mandikrasniqi@gmail.com*

Abstrakt

Kjo temë pasqyron një vështrim autorial lidhur me kompleksitetin e tregut të sigurimeve në Kosovë. Për shkak të te kaluarës, dominimit të rrethanave të posaçme politike, tranzicionit të vonuar shoqëror, dobësive në zhvillimin ekonomik, mungesës së funksionimit të shtetit ligjor në masën e mjaftueshme në mënyrë specifike tregu i sigurimeve dhe vet sigurimet si institucione karakterizohen me një zhvillim të dobët dhe probleme evidente në vendin tonë. Numri kompanive që operojnë në këtë treg dhe numri i produkteve të ofruara, qofshin ato të detyrueshme ose ato vullnetare, është i vogël. Kjo jo vetëm për shkak të ndikimit rrethanave të cekura më sipër por edhe për shkak të ndërgjegjësimit jo të mjaftueshëm të qytetarëve për dobiet nga sigurimet, të mungesës së programeve qeveritare dhe mungesa e konsiderueshme e bazës legjislative. Andaj, pritet që në Kosovë së shpejti lëmi i sigurimeve të detyrueshme të rregullohet me ligj me të avancuar. Nëpërmjet kësaj baze të re ligjore do të duhet që të rregulloheshin çështjet e mbikëqyrjes institucionale të sigurimeve. Përkrah rregullimit legjislativ të kësaj fushe në përputhje me standardet e nevojshme ndërkombëtare është e domosdoshme edhe krijimi i një sistemi kontrolli institucional relativisht liberal. Sa se i kontrolluar do të jetë ky sistem do të varet pikërisht nga niveli i zhvillimit socio - ekonomi të vendit, kërkesat që shoqëria i parashtron para këtij sistemi mbrojtës dhe gatishmëria e tregut të sigurimeve për ofrimin e këtij shërbimi.

Fjalët kyçe: Sigurim, legjislacion, rregullore, konventë polisë, premi, risk.

1. Hyrja

Bota moderne është e mbushur me ngjarje të paparashikueshme. Risku, term i përdorur për të shprehur probabilitetin e një humbjeje, kërcënon vazhdimisht individët, shoqatat si edhe shoqërinë në përgjithësi. Risku është një pasiguri apo një mundësi e paparashikueshme për të ndodhur një fatkeqësi, që shkakton humbje dhe që shprehet në një dëm ekonomik.

1 Autori është mësimmhënës në Universitetin e Prishtinës – Fakulteti Ekonomik në Prishtinë dhe Fakulteti I Biznesit në Pejë

Pyetja kryesore që mund të bëhet sot për sigurime është se a ka treg të mirëfilltë sigurimesh në Kosovë, cili është funksioni i tij tregtar dhe cila është baza ligjore e veprimit të tij. Sa dhe si janë të informuar qytetarët, bizneset për ekzistencën e këtij tregu sigurimesh? Sigurisht, këto janë disa nga pyetjet thelbësore që duhet ngritur dhe që kërkojnë përgjigje se kush e ka përgjegjësinë për të mbështetur këtë lëmi në mënyrë që të sigurojmë ndonjë studim të mirëfilltë e të detajuar i cili vërtetë sot i mungon Kosovës. Natyrisht, së pari kjo pritet nga instancat relevante qeveritare, shoqëritë e sigurimeve dhe nga grupet e interesit. Megjithatë në nivelin e sotëm nisur nga të dhënat dhe njohuritë që disponojmë një përgjigje mund të jepet: Tregu i sigurimeve në këtë vend ekziston por sa është shtrirja e tij e saktë kjo nuk dihet qartë. Në qoftë se, sot në territorin e këtij vendi pyetet një qytetar i thjeshtë se ç'farë janë sigurimet, prej tij mund të merren dy përgjigje në thelb të ndryshme: Sigurimet që paguhën për të marrë pensionin dhe e dyta sigurimi për vetura! Pra tek ne, nuk ekziston një koncept i qartë mbi sigurimet. Në çdo moment mund të ngatërrohen sigurimet shoqërore, pensionale, etj, me sigurimet e tjera. Kjo vjen nga mungesa e edukimit të popullatës mbi konceptin dhe rëndësinë për sigurimeve. Në qoftë se ne mendojmë se në drejtim të bazës ligjore për sigurimet ekziston një legjislacion jo shumë i përshtatshëm ndërsa për kompletimin e tij nga ana e qeverisë janë duke u marrë masa për përafrimin e tij me standardet evropiane në drejtim të rritjes së kontrollit shtetëror mbi veprimtarinë e sigurimeve, kjo nuk po ndodh. Deri me tani nuk është duke u punuar edhe në aspektin e rritjes së ndërgjegjes qytetare për përfshirjen e në tregun e sigurimeve. Kjo deri në një masë mund të arsyetohet me rrethanat se kjo gjendje është rezultat se në Kosovë përveç normës së lartë të papunësisë, popullata e saj ka një përqindje shqetësuese të varfërisë. Megjithatë, kjo nuk duhet të nënkuptohet se kjo industri duhet të ngecë, përkundrazi së paku qytetarët duhet të vetëdijësohen dhe ndërgjegjësohen për dobinë që sjellin sigurimet edhe në kushtet e varfërisë. Shembuj konkretë nga shumë vende të zhvilluara perëndimore por edhe nga ato në zhvillim tregojnë gatishmërinë e qeverive për të marrë edhe masa të kufizuara shtrënguese për ndërgjegjësimin e popullatës në tregun e sigurimeve. Sot ky fenomen është aq i theksuar në këto vende sa është vështirë që të gjesh aspekt të jetës së përditshme të tyre ku të mos merret në konsideratë veprimtaria siguruese. Nisur nga kjo vërtetohet se, sikurse edhe në perëndim, promotori dhe investuesi i ndërgjegjes qytetare në këtë plan fillimisht duhet të bëhet shteti i tyre. Me këtë nuk duhet nënkuptuar se çdo gjë duhet të bëhet vetëm nga shteti që është kompetent për nxjerrjen e ligjeve dhe vendimeve shtrënguese për të detyruar qytetarët, bizneset për të bërë sigurimet e pasurisë së tyre. Detyra e institucionale shtetërore duhet fokusuar deri në një moment racional që kë të bëjë me rritjen e shkallës së ndërgjegjes qytetare në mënyrë që gjithsecili

=====

duhet ta kuptojë se marrja e masave për të siguruar gjithçka që lidhet me veprimtarinë e tij të përditshme, pasurinë e tij, është një domosdoshmëri. Shembujt janë me së evident dhe konfirmojmë se edhe vetë perëndimi që ka arritur deri këtu ka arritur me forcën e ligjit. Në fund të fundit demokracia është zbatimi i ligjit.

2. Trendët e zhvillimit të industrisë së sigurimeve në Kosovë

Edhe pas 12 viteve nga fillimi i veprimtarisë moderne të industrisë së sigurimeve, përsëri pohohet që ky treg është ende i pazhvilluar. Treguesi kryesor është padyshim shkalla e ulët e penetrimit të sigurimeve si në biznese ashtu dhe tek individit dhe familjet kosovare. Mesatarisht, një individ paguan në vit me pak se 10 euro për sigurimet të detyrueshme dhe fare pak për ato vullnetare. Me fjalë të tjera, Kosova ka raportin më të ulët në Evropë, GDP – së me primet e grumbulluara brenda një viti. Ndërkaq dhe struktura e primeve të grumbulluara (raporti midis produkteve të shitura) tregon se tregu në pjesën dërmuese vazhdon të mbizotërohet nga sigurimet e detyrueshme (sigurimi i detyrueshëm i mjeteve motorike dhe nga pagesa nga pagat të dedikuara për fondin pensional). Po t'i shtojmë këtyre dhe sigurimin e makinave të quajtur kasko dhe sigurimin kufi (të sigurimit të detyrueshme të makinave me targa të huaja që hyjnë në territorin e Kosovës) atëherë mund të themi që tregu i sigurimeve dominohet nga sigurimi motorik në mbi 90% të tij.² Në kuptim të thjeshtë mund të themi së tregu kosovar i sigurimeve është i tepër i vogël jo vetëm në krahasim me fqinjë por edhe me mundësitë potenciale që ka edhe vet ekonomia vendore. Me gjithë vështirësitë ekonomike – sociale në këtë nivel të ulët të zhvillimit të industrisë së sigurimeve janë identifikuar edhe çështjet që kanë të bëjnë me atë se sigurimet janë një industri që duhet mbështetet në: infrastrukture ligjore komplekse; në modele teknike të sofistikuara të vlerësimit dhe administrimit të rreziqeve; në njohjen e teknikave për transferimin e rreziqeve në tregun ndërkombëtar të risigurimeve; në një kulturë minimale të njohjes së publikut.

Sot në botën post – moderne sigurimet konsiderohen si njëra nga industritë më të rregulluara në planin legjislativ. Kjo ndodh për faktin se ato janë një industri në interesin e publikut ku kompanitë grumbullojnë para për të marrë përsipër detyrime ndaj një publiku të gjerë në mënyrë të detyrueshme apo dhe vullnetare. Çdo arkëtim i kompanive të sigurimeve “krijon” përgjegjësi të shumëfishtë për klientët në rast aksidentesh apo

2 Rregullorja e UNMIK – ut 2001/25 të datës 5 tetor 2001 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e veprimtarisë së kompanive të sigurimit dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit, Me qëllim të zbatimit të nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25, Bordi Drejtues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2008, miratoi si në vijim: Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto – përgjegjësisë.

fatkeqësish natyrore. Përveç kushteve të licencimit dhe të kryerjes së aktivitetit të kompanive (të cilat rregullohen me ligjin e sigurimeve dhe risigurimeve), për çdo produkt apo kategori rreziqesh ka rregulla të përcaktuara që kompanitë janë të detyruara t'i respektojnë. Nga ana tjetër, aftësia paguese minimale, kapitali dhe rezervat (fondi i gatshëm për pagesën e dëmeve që do të ndodhin në të ardhmen), janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në ligj dhe akte të tjera nënligjore. Në kushtet e Kosovës, në masën me të madhe sistemi ligjor, në pjesën e akteve nënligjore, nuk është kompatibil me sistemet evropiane të sigurimeve. Kuadri ligjor duhet të rregullojë, kontrollojë dhe vlerësojë rreptë çdo element të aktivitetit të sigurimeve. Mjafton të përmendet së për çdo ndryshim në statut të ndonjë kompanie të sigurimeve, sado i parëndësishëm të jetë, duhet marrë më parë miratimi i Institucionit Mbikëqyrjes të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). Ligjet e reja për organizmin dhe funksionimin e këtij autoriteti të mbikëqyrjes, si dhe ato për licencimin e agjentëve, udhëzimin e trajtimit të dëmeve apo dhe rregulloret për aftësitë paguese dhe llogaritjen e provizonve teknike, janë një pjesë e panoramës ligjore që rregullon tregun e sigurimeve. Përkrah rregullimit dhe kompletimit të bazës legislative është që me urgjencë të përmirësohet kontrolli ndaj deformimeve të tregut dhe njëkohësisht ulja e paarsyeshme e çmimeve tej vlerësimit real të riskut. Çdo kontratë që hidhet në treg, përveç anës legale, ku parashikohen detyrimet dhe të drejtat e kompanisë dhe të klientëve, ka të "investuar" një punë paraprake teknike në lidhje me llogaritjen e premisë, të vlerësimit të llojit dhe të masës së rrezikut, të vlerësimit, mbajtjes së kompanisë (sa ka mundësi që kompania të marrë përsipër vetë dhe sa duhet të transferojë në risigurim).³ Ky proces sidomos është i domosdoshëm kur është fjala për sigurimin e pronës. Në tregjet e zhvilluara dhe të mëdha zbatohen modele të njohura të statistikës matematikore për të identifikuar dhe vlerësuar tendencën e ngjarjeve të papritura të natyrës por dhe të llojeve të tjera të rreziqeve sikurse janë aksidentet automobilistike. Në analizë të fundit ajo që kërkohet të dihet është se, deri në çfarë probabiliteti mesatar mund të ndodhë një ngjarje (shpeshësia e ndodhjes së një aksidenti), përmasat mesatarë të humbjeve financiare, si dhe probabilitetin maksimal të humbjes për një ngjarje. Mbi bazën e këtyre konkluzioneve ndërtohet sistemi tarifor i përshtatshëm për të krijuar një sasi të ardhurash të mjaftueshme për të përballua dëmet, rezervat dhe shpenzimet administrative.

3 Rregullorja e UNMIK – ut nr. 2001/25 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit e të ndërmjetësuesve të sigurimit e dt. 05 tetor 2001, neni 57 deri ne 63.

3. Mungesa e kulturës së sigurimeve dhe ndërgjegjësimi i qytetar

Është i njohur botërisht fakti se vendet e botës klasifikohen sipas shkallës së zhvillimit ekonomik në: vende të zhvilluara, vende në zhvillim dhe vende të botës së tretë. Industria e sigurimeve është një ndër treguesit kryesorë për shkallën e zhvillimit ekonomik të një vendi dhe pranisë së dukurive informalitetit në të. Në vendet e zhvilluara (për ndryshim nga Kosova) mbizotëron edukata e konsoliduar e popullatës për nevojën e sigurimeve si rrjedhojë e zhvillimit të institucionit të pronës private dhe interesit monetar. Ndërsa në vendin tone, nisur nga gjendja e tanishme, njëra ndër detyrat kryesore të shoqërive të sigurimit del të jetë aktiviteti për nxitjen e ndërgjegjësimit të popullatës për domosdoshmërinë e tyre për sigurime duke zbuluar në këtë mënyrë potencialet e një tregu të “fjetur” apo të “mundshëm”. Në vendet me ekonomi të zhvilluar mbizotërojnë ndjeshëm të ardhurat nga sigurimet e jetës, pronës përkundrejt atyre motorike. Kjo medalje ka anën e vet të dytë e cila përkthehet dhe që rezulton me atë se edhe fusha ku investojnë kompanitë e sigurimeve, të ardhurat e mbledhura nga sigurimet e jetës janë shumë më e gjerë sesa në vendet në zhvillim. Vihen re investime afatgjata kryesisht nëpërmjet bursës e tregut të letrave me vlerë. Ndërkohë që shoqëritë e sigurimeve për nga statusi financiar janë barazuar me bankat e nivelit të dytë dhe lëvrojnë njësoj si to kredi konsumatore. Për sa i përket premisë së sigurimeve, nëse e marrim si dukuri matematikore kompleks, vlerësohet se është tregues i raportit prime – dëme (që për kushtet e tregut kosovar është pozitiv) dhe i çmimit të shërbimeve të ofruara në rast dëmi, si dhe çmimit të pronës private. Kjo na bën të mendojmë që niveli i çmimit të sigurimeve në Kosovë përkon me nivelin e vetë tregut të sigurimeve, d.m.th. shërbimit që shitet dhe blihet në ekonominë tonë.

4. Procesi i liberalizimi të tregut të sigurimeve në Kosovë sfidë, mundësi ose nevojë

Liberalizimi i tregut të sigurimeve pa dyshim ishte njëri ndër prioritetet e Bankës Qendrore të Kosovës për shkak të synimeve të qarta të vendit të drejtuar harmonizimit të legjislacionit vetanak me direktivat evropiane. Shkak tjetër ishte edhe nevoja e përcjelljes së trendëve në industrinë e sigurimeve si në rajon ashtu edhe më gjerë. Të gjitha këto ndryshime shtyn autoritetet në Kosovë të marrin hapat konkret drejt liberalizimit në një shkallë të caktuar të tregut të sigurimeve. Karakteristikë e një logjike liberale konsiderohet të jetë procesi i liberalizimit i TPL – së. Kjo për shkak se industria e sigurimeve pretendohet të jetë sistem – treg i hapur ku nuk ka kurrfarë kufizimesh në strukturën e pronësisë së kompanive si dhe nuk ka kufizime tjera, të cilat në një mënyrë apo tjetër, do të favorizonin

kompanitë vendore në krahasim me kompanitë e jashtme.⁴ Mbi bazën e legjislacionit aktual vendor në industrinë e sigurimeve mund të operojnë edhe operatorë të jashtëm, ndërsa struktura e pronësisë brenda një kompanie nuk ka kurrfarë limiti në relacion pronar të brendshëm apo të jashtëm. Sa i përket investimeve ato janë të liberalizuara sepse çdo kompani mund të investojë varësisht politikave dhe filozofisë së investimit të saj. Kufizimet në relacion me risiguruesin kanë të bëjnë me nivelin e mbajtjes së rrezikut jo në cedimin e detyrueshëm në tregun e brendshëm, siç është rasti me vende të ndryshme, ku imponojnë kompanitë vendore dhe të jashtme që të cedojnë nivel të caktuar në kompani risiguruese vendore.⁵

Por realisht vetëm në vitin 2007 fillohet të mendohet lidhur me liberalizimin e tregut të auto – përgjegjësisë sepse bazuar në rrethanat shoqërore të vendit tonë, ky produkt ishte dhe ende mbetet i detyrueshëm. Gjatë këtij viti arrihet të ngritët një komision profesional – ekspertësh të cilët së bashku me Bankën Qendrore dhe kompanitë e sigurimit të krijojnë të një projekt për liberalizimin e tregut të sigurimeve në vend. Specifikat e Kosovës në atë kohë kanë qenë shumë të ndryshme prej të tjerëve.⁶ Që në fillim kemi potencuar se i gjithë tregu i sigurimeve në Kosovë ishte mbi 92% nga auto – përgjegjësia. Ekzistimi i një projekti për liberalizim është shoqëruar me shqetësime të ndryshme⁷ gjë që rrethanat që ndikuan orientuan drejt një qasje e cila bazohej në dilemën për shkallën e liberalizimit të kontrolluar apo tërësisht të lirë. Projekti në fjalë ofronte zgjedhje të përcaktuara ose metoda të cilat do të zgjidhen për shkallën e liberalizimit të tregut të sigurimeve. Mirëpo, pikërisht nga kjo shkallë e liberalizimit të tregut do të varej konkurrenca në garë dhe në çmime. Interesante të potencohet është fakti se me rastin e hartimit të kësaj strategjie ka arritur që vetëdija e kompanive do

4 Kosova aktualisht nuk është anëtare e Sistemit të Kartanit të Gjellbër pasi që Neni 4.2. i Kushtetutës së Këshillit të Byrove kërkon që një Byro e cila synon që të anëtarësohet duhet të jetë nga një shtet i njohur ndërkombëtarisht dhe të jetë i pranuar si anëtar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Andaj në mungesë të kartanit të gjellbër ngasësit e veturave të cilët dëshirojnë që të hyjnë në Kosovë duhet të pajisen me sigurim kufitar për sigurimin e autopërgjegjësisë të veturave me tabela të huaja që nënkupton mbulimin e të gjitha dëmeve të shkaktuara ndaj palës së tretë.

5 Për më shumë shih në rregullorja e UNMIK – ut nr. 2001/25 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit e të ndërmjetësuesve të sigurimit e dt. 05 tetor 2001.

6 Shoqata e Sigurimeve Kosovës – IAK, është themeluar në Prill të vitit 2002, në bazë të marrëveshjes së Kompanive të Sigurimit të cilat janë të licensuara për ta ushtruar aktivitetin e tyre të Sigurimeve në Kosovë. Shoqata është themeluar me qëllim të përmirësimit të Industrisë së Sigurimeve në Kosovë, të ndihmojë në stabilitetin e tregut të Sigurimeve, të ofrojë edukim për stafin e Kompanive të Sigurimit, si dhe për rritjen e resurseve njerëzore në përgjithësi, në lëmin e sigurimeve. Prioritet tjetër i Shoqatës janë edhe organizimet e seminareve dhe konferencave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të merret me informimin e publikut për lëmin e sigurimeve në përgjithësi. Për më shumë shi në: <http://www.iak-ks.com/shqip/aboutus.html>

7 Përgjegjësia e komisionit që mos të përcaktohen mekanizma strategjik që do të ndikojnë dhe lejonin që të ndodhë një gjendje e Greqisë nga liberalizimi, ku kishin falimentuar 30 kompani të sigurimit, ka falimentuar Fondi I Garancisë, i cili me kreditë të mëdha mezi është dalë nga kriza, Gjermani kanë falimentuar një pjesë e kompanive të vogla, edhe ka pasur humbje, mbi 2 miliardë euro.

=====
orientohet në nxjerrje produktet në bazë të kushteve të sigurimit por doli që ajo nuk ndodhi por procesi prodhojë gjendjen e uljes së çmimit mesatarisht për 24 – 25%. Nga kjo situatë e krijuar doli se asnjë kompani nga kjo garë në treg nuk mundi të përfitojë asnjë hapësirë më të madhe në treg se sa që e kishte përpara. Me këtë rezulton që të jetë zvogëluar premia TPL për tremujorin e parë të vitit 2009 për 16% dhe të zvogëlojmë pjesën e pagesës së dëmeve për 17%. Kjo gjendjeje as që është analizuar në mënyrë të detajuar të premisë dhe të dëmeve. Pavarësisht nga posedimit ose jo i të dhënave nga kushdo qoftë paraqet nevojën e krijimit të një bazë të re të dhënave me shënimet e sakta për historinë e dëmeve. Vetëm në bazë të tyre dhe rekomandimeve të tjera të arrihet deri te një material, në bazë të cilit do të ishte e mundur me nxjerrshin konkluzione lidhur me nevojë dhe shkallën e liberalizimit të tregut të sigurimeve në vend.

5. Modernizimi i legjislacioni në sferën e sigurimeve në Kosovë kusht për liberalizmin e fushës së sigurimeve në Kosovë

Në Kosovë sot mungon Ligji mbi sigurimet e përgjithshme që në instancë të fundit do duhet të jetë burimi dhe baza e tërë legjislacioni primar dhe sekondar në sferën e sigurimeve. Rrjedhimisht, ende në fuqi ekziston Rregulloren e UNMIK 2001/ 25, e cila në aspektin aktual e rregullon këtë segment të rëndësishëm jetësor se si funksionojnë në tërësi kompanitë e sigurimit. Thënë realisht për kohën, dinamikën dhe nevojën e zhvillimit të vendit fare nuk është adekuate. Për këtë në mënyrë të padiskutueshme parashtrohet nevoja shoqërore që urgjentisht të nxjerrën, plotësohen ose ndryshohet baza aktuale ligjore duke e transformuar në një legjislacion kompatible në standardet evropiane. Nxjerrja e këtyre ligjeve sistemore, akteve nënligjore, të përgjithshëm apo të veçanta, për të rregulluar sferën e sigurimeve të detyrueshme ose vullnetare, do ta rregullonte qartë çështjen e përcaktimit të fushës, veprimtarisë dhe kompetencave të institucionit të sigurimeve. Theks të veçantë dhe meritë do të duhej t'i përcaktohej rregullatorit institucional në cilësi të mbikëqyrësit për rregullimin funksional të tregut të sigurimeve dhe njëkohësisht do të ndikonte që të krijoheshin standarde të përshtatshme mbi bazën e konkurrencës së lirë dhe arritjen e një shkalle optimale të liberalizimit. Së paku sipas perceptimi tonë, te shumica nga grupe e interesit që veprimtarinë banesore e kanë të fokusuar në sigurime është krijuar bindja se në qoftë se ndodh liberalizimi i tregut të sigurimeve, shteti heq dorë prej tarifave dhe do humb rolin e rregullatorit. Kjo jo vetëm që është një perceptim tërësisht i gabuar por edhe tërësisht i pamundshme. Pavarësisht nga shkallë e caktuar e liberalizimit në tregun e sigurimeve, institucionit të Rregullatorit për shkak të rolit dhe rëndësisë që ka në këtë sferë, qartë bazë të ligjit i përcaktohen detyrat dhe veprimtaria e cila

=====

konsiderohet si shumë rigoroz që fillimisht të kërkojë një sistem të besueshmërisë së kapitalit, të kërkojë informacionet e sakta për rezervat e kompanive, t'i azhurnojë dhe analizojë këto të dhëna, llogaritjet e rezervave të dëmeve, etj.. Meqë ligjërisht Fondi i Garancisë ende nuk është i normuar tek ne, për rolin që ka, ky mekanizëm jo vetëm që duhet rregulluar qartë dhe sakët por funksioni i tij duhet jetë eficientë.⁸ Mungesa e një fondi të tillë e rritë pasigurinë e tërë sistemit të sigurimeve pikërisht për faktin se në rast të falimentimit të një kompanie të sigurimit do të krijohen vështirësi në kompensimin e dëmeve individuale nga fondi. Nëse ndodh që mbajtësi i policës të një kompanie të sigurimeve e cila eventualisht mund të shkojë në likuidim, nuk ka mundësi që të përmbushët kërkesa nga proceset likuiduese për shkak të mungesës së aseteve likuiduese të cilat nuk i ka kompania, atëherë këto gjëra do të duheshin të kompensoheshin nga Fondi i Garancisë dhe të gjitha kompanitë rrjedhimisht do të nuk do kishin humbje serioze.⁹ Pikërisht për këtë arsye përcaktimi i rolit të Rregullatorit në këto momente duhet të jetë i rregulluar strikt me ligj, i qartë në përmbajtje por edhe efikas në zbatim. Në rrethanat e krizës globale financiare shpesh është konstatuar se liberalizimi i tepruar ka sjellë krizën financiare andaj dilemat rreth kësaj çështje do të mbeten ende. Lidhur me këto mendime ne mendojmë se sigurimet me së paku mund të shpallën fajtoresh për këtë krizë, përkundrazi. Keqpërdorimi i drejtësisë, keq – menaxhimi dhe injorimi i rregullave profesionale janë shkaqet e krizës. Andaj ligji çështjen e sigurimeve në vendin tonë duhet të trajtojë në dy dimensione. Së pari për shkak të gjendjeje aktuale duhet që të lejohen që të gjitha premittë për klasat e sigurimeve vullnetare të janë të liberalizuara, ashtu që kompanitë e sigurimeve, bazuar në vlerësimet dhe rregullave profesionale në mënyrë të lirë i përcaktojnë ato, ndërkaq Rregullatori të bëjë aprovimin apo mos – aprovimin e tyre.¹⁰ Së dyti, pjesa e cila i dedikohet sigurimeve të detyrueshme duhet të sigurohet një

8 Momentalisht kjo çështje rregullohet me Rregullin 9 mbi përshkrimin e kërkesave për rezerva të kompanive të sigurimit të bazuar në përputhje me autorizimin që është dhënë sipas nenit 17. b të Rregullores së UNMIK-ut 2001/24 të datës 01 Tetor 2001 mbi ndryshimin e Rregullores Nr. 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor 2001 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e Kompanive dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit, me qëllim të zbatimit të nenit 28 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25,

9 Rregulli 30 mbi validitetin dhe shumën e aksionarëve dhe dëmeve të kreditorëve, në likuidim i bazuar në nenin 17. b të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24, të datës 1 Tetor, 2001 për rregullimin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, mbi autoritetin bankar dhe të pagesave të Kosovës, dhe nenit 3.3 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor, 2001 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullat e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit. Me qëllim të zbatimit të nenit 74 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

10 Ligji për konkurrencën Nr. 2004/36 ka për qëllim i këtij ligji që të siguroj zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme të regut në Kosovë duke ndaluar veprimet që e kufizojnë, shtypin ose çrregullojnë konkurrencën.

=====

legjislacioni i cili liberalizimin e tregut të sigurimeve do rregullojë në mënyrë më të kontrolluar dhe relativisht të liberalizuar.

Legjislacioni i sigurimeve duhet të rregullojë në proces ku menaxheri i riskut duhet të ketë parasysh të gjitha hapat e procesit të menaxhimit të riskut që ai të jetë sa më i suksesshëm në këtë proces. Andaj, rregullimi ligjorë i kësaj çështje në esencë procesin e menaxhimit të riskut do të arrijë që të maksimizojë qoftë mbi hapësirat dhe mbi rezultatet e të cilave kemi kontrolli. Në anën tjetër do arrihet që të minimizohen ato hapësira mbi rezultatet, e të cilave nuk kemi absolutisht asnjë lloj kontrolli. Me sipër kemi konstatuar se tregu i sigurimeve në Kosovë është një treg modest dhe i përqendruar në sigurimin e detyrueshëm. Mirëpo volumi i sigurimit vullnetar paraqet shëndetin e një tregu sigurimesh, i cili në vend është ende në nivele të ultë. Nga kjo rrjedh që legjislacioni duhet të ketë fleksibilitetin e duhur që të mundësojë rritje dhe stimulimin e sigurimit vullnetar. Po ashtu, rritja dhe zhvillimi i planeve marketing për përmirësimin e imazhit të kompanive të sigurimit, duke sjellë një njohje më të madhe të shërbimeve të ofruara prej tyre. Ofrimin e një game më të gjerë shërbimesh si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës, si dhe një shërbim më të mirë ndaj klientelës

6. Liberalizimi i sigurimeve të detyrueshme duhet të jetë i kontrolluar

Procesi i liberalizimit në disa prej shteteve ka ecur më përpara, disa janë në fillim e disa janë diku në mes. Pikërisht për këto arsye liberalizimin duhet perceptuar si një proces evolutiv, i cili çdo herë duhet të përmirësohet dhe të kërkojen mundësi për ndonjë kalim të lehtë dhe harmonizim me direktivat evropiane.

Në fakt që flasim për liberalizimin e plotë, në pjesën e rregullativës ligjore, sipas disa vlerësimeve nga ana e ekspertëve ligjore të vendeve me një treg të zhvilluar sigurimesh në rajon, duhet të rezultojë me një përshtatjen e plotë të më shumë se 50 ligjeve, të cilët duhet të përcaktojnë, rregullojnë dhe përcjellin biznesin e sigurimeve. Si të tilla nuk duhet konsideruar vetëm Ligjin për auditim të sigurimeve apo Ligjin e sigurimit të detyrueshëm, por një tërësi ligjesh kompleks që duhet të përshtaten në mënyrën më adekuate, që të krijohen mundësi për qasje të plotë të kapitalit të kompanive, që vijnë nga jashtë. Pas rregullimit të kësaj pjese legislative krijohen kushtet dhe rrethanat që liberalizimi në sigurimet jo të detyrueshme të jetë tërësisht i lirë dhe në ato të detyrueshme pjesërisht i liberalizuar. Në tregun e sigurimeve të pronës duhet shikuar mundësinë e uljes permanente të premisë së përgjithshme. Në pjesën e sigurimeve të detyrueshme duhet ndërruar qasja për liberalizim sa më të shpejtë në pjesën e sigurimit nga auto – përgjegjësisë. Procesi i plotësimit të ligjeve duhet të ecë më shpejt në vendin

=====
tonë, për arsye se mosrespektimi i caktuar apo mospërfundimi i rregullativës ligjore kontribuon që pjesëmarrës të caktuar në treg të krijojnë një gjendje kaotike, duke mos respektuar rregullat apo profesionin e sigurimeve edhe te ky lloj i sigurimeve të auto – përgjegjësisë. Çmimi për sigurimin e auto – përgjegjësisë në Republikën e Kosovës është definuar dhe është nën kontrollin e organit qeveritar, përkatësisht Komisionit, i cili merret me çmimet adekuate të sigurimeve që i përgjigjet lartësisë së dëmit. Objektivi kryesor i Bankës Qendrore të Kosovës duhet të fokusohet në përgatitjen e ligjeve të reja për sigurimet në përputhje me direktivat e Unionit Evropian duke respektuar këtu edhe veçoritë e Kosovës. Gjithashtu, me ndihmën e ekspertëve të Bankës Botërore duhet përgatitur edhe Ligjin mbi sigurimet e detyrueshme.

7. Përfundime dhe rekomandime

Nga askush nuk ka dilema se vendi ynë duhet të krijojë një treg të përgjegjshëm të industrisë së sigurimeve përmes krijimit të kushteve bazë të funksionimit. Që të realizohet kjo është e domosdoshme që të ngritët niveli ligjor respektivisht legjislacioni në lidhje me liberalizimin e sigurimit. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës jemi përcaktuar për ekonomi të tregut të lirë dhe të hapur, prandaj është plotësisht e kuptueshme që edhe industria e sigurimeve duhet të ecë në këtë drejtim. Korniza ekzistuese ligjore e sigurimeve, Rregullorja 2001/25, aktualisht edhe pse jo e përshtatshme për kohën ka qenë e bazuar apo mbështetur në praktikën më të mira të ligjeve ndërkombëtare dhe është e përafërt me direktivat e Unionit Evropian sa i përket organizimit të sigurimeve. Kjo rregullore deri me tani ka krijuar një treg të hapur të sigurimeve, ka siguruar lirinë e hyrjes së sigurveve në tregun e sigurimeve të Kosovës, ka siguruar lëvizjen e lirë të kapitalit, shpërndarje të lirë të dividendës, ka siguruar pozicion të barabartë të të gjithë sigurveve, pa marrë parasysh vendin e origjinës, a janë vendorë apo të jashtëm. Megjithatë, tani jemi të bindur se kompletimi i bazës legjislative për sigurimet duke e pasur parasysh shkallën e liberalizimit të këtij segmenti edhe pse jo lehtë konsiderohet nevojë urgjente. Kjo së pari për shkak se Autoriteti i Konkurrencës në mënyrën profesionale nuk do të lejonte që tregu i sigurimeve të dirigjohet dhe kontrollohet në kundërshtim me parimet e ekonomisë së tregut. Pavarësisht nga vështirësitë dhe rreziqet në asnjë mënyrë nuk duhet përjashtuar procesi i liberalizimit të kësaj lëmi. Procesit të liberalizimit duhet t'i sigurohet një regjim i posaçëm. Çdo intervenim i shtetit në këtë lëmi nuk duhet kuptuar si mohim i iniciativës apo kërkesës për realizim të liberalizimit, por në këto relacione duhet të ketë bashkërenditje dhe akordim. Ky treg, përkatësisht kjo industri në Kosovë edhe pse shumë e

=====

re ka shënuar suksese evidente gjatë kësaj periudhe edhe pse jo edhe te mjaftueshme.

Kompanitë e sigurimeve ekzistojnë, për shkak të klientëve dhe mbulimit të rreziqeve të tyre. Prandaj, trajtimi adekuat i klientëve dhe të drejtave të tyre për kompensim të dëmit, në rast të ndodhjes së rastit të siguruar, meriton një qasje dhe trajtim më cilësor. Pra, rritja e konkurrencës nënkupton dinamizëm, zhvillim, përgjegjësi dhe transparencë. Fjala është për auto – përgjegjësinë, e cila në shumicën e vendeve në botë është buzë rrënimit ose ballafaqohet me humbje të mëdha, mirëpo në Kosovë gjatë katër viteve ky sektor i industrisë ka qenë profitabil. Nuk do mend, kjo ka ndodhur, para së gjithash, për shkak se në treg ka qarkulluar numër i madh i vetura të vjetra. Mirëpo, sot në rrugët e Kosovës sigurisht kemi 10 për qind të veturave të reja, gjë që e ndryshon gjendjen ekzistuese në këtë sektor, sepse vlera është në rritje. Së këndejmi, është e domosdoshme që Rregullatori, i cili në këtë rast është Departamenti përkatës i Bankës Qendrore të Kosovës, duhet të monitorojë edhe më tutje, si solvencën e rezervës teknike po ashtu edhe dëmet. Duket se baza legislative ekzistuese imponon një liberalizim të plotë por edhe nevojën që institucionet e rregullimit të tregut të kenë rolin dhe funksionin adekuat në mënyrë që të mund t'u sigurojë operatorëve mbijetesë në tregun ekzistues. Rrethanat aktuale shtrojnë nevojën e një liberalizimi të kontrolluar në sferën e sigurimeve të detyrueshme, përndryshe ekziston mundësia që nesër mund të shuhen të gjithë. Me qasjen e re, në fokus të Rregullatorit nuk është rregullimi i tregut, por krijimi i standardeve për një garë korrekte në treg, sepse tregu është ai që duhet ta rregullojë pozitën e secilës kompani veç e veç, duke u bazuar në konkurrencën dhe kualitetin e shërbimeve dhe në transparencë. Rritja e konkurrencës nënkupton zhvillim të kompanive të sigurimeve, zhvillim të kapaciteteve të tyre menaxhuese, rritje të cilësisë së shërbimeve të tyre, vënie në epiqendër të klientit dhe të interesave të tij. Procesi i kompletimit të legjislacionit konform me aktet dhe standardet me të larta ndërkombëtar duhet shikuar si një proces të vazhdueshëm duke i zgjedhur problemet ekzistuese, në mënyrë që kompanitë edhe më tutje jo vetëm të ekzistojnë së funksionuari por të jenë edhe profitabile. Insistimi se Kosova duhet të punojë pareshtur dhe me profesionalizëm në përafrimin me legjislacionet e Bashkimit Evropian është më shumë se detyrë dhe e pa – alternativë. Në procesin e kompletimit të legjislacionit duhet presim një rol angazhues dhe kontribut jo vetëm të aktorëve dhe operatorëve të industrisë së sigurimeve, Shoqatës së Kompanive të Sigurimeve, Qeverisë, Agjencisë për Konkurrencën, të shoqërisë civile, të ekspertëve të lëmit, por edhe të ekspertëve të Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe USAD. Në këtë drejtim duhet ecur me kujdes, duke u mbështetur në analiza dhe vlerësime profesionale. Për këtë qëllim, Banka Qendrore e Kosovës duhet të

kërkojë asistencë nga Banka Botërore në mënyrë që të kemi disa misione të ekspertëve të këtij institucioni me renome , të cilët do të vlerësojnë aspekte të veçanta të kësaj çështjeje.

Literatura

1. Maciej Sterzynski, The European Single Insurance Market:Overview and impact of the liberalization and deregulation processes
2. Jennifer M. Oetzel, Market Liberalization and Insurance Firm Performance in Emerging Markets & Developing Countries
3. Welf Werner Multilateral Insurance Liberalization, 1948 – 2008
4. Joseph Francois IanWooton, Market Structure, Trade Liberalization and the Gats
5. ICC, The world business organization, The liberalization of trade in insurance Services, Prepared by the Commission on Financial Services and Insurance
6. Stephen Woolcock, Liberalisation of Financial Services
7. Klime Poposki, Globalization of the Insurance Industry and Emerging Markets
8. Christian Noyer, “The Challenges of financial liberalisation for Emerging Market Economies” International Chamber of Commerce